

“STRATEGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË”.

Intervistë dhënë gazetës “Shekulli”, në 19 janar 1999.

Data 31 dhjetor 1998 shënoi një moment historik në tregun finciar jo vetëm europian, por dhe atë botëror, duke hedhur në tavolinë, euron. Përgatitjet për këtë hap ishin bërë me krijimin e Bashkimit Monetar Europian (EMU) si një nga projektet më ambicioze të diskutueshme në kuadrin e Europës së Bashkuar. Kjo shënoi kthimin në realitet të një ëndrrë të nisur që nga vitet '50, kur Jacques Rueff shkruante se “Europa do të ndërtohet nga një monedhë e përbashkët ose nuk do të ndërtohet fare.”

Duke fiksuar përfundimisht vlerën e këmbimit të modhave kombëtare të 11 vendeve, u hodh një hap i guximshëm. Duket se hedhja e hapave të tjerë do të shoqërohet me shumë sfida, realizimi me sukses i të cilave do të kërkojë patjetër një kordinim të politikave ekonomike, fiskale dhe monetare, të vendeve të përfshira në euro, tashmë nëpërmjet Bankës Qendrore Europiane.

Përballë këtij realiteti natyreshëm lind pyetja: Ç’kontakte ka e do të ketë Shqipëria me Zonën e Euros dhe ç’do të bëjë ajo për t’u përfshirë në të?

Në qoftë se për një çast do ta përfytyronim Zonën e Euros në një formë rrethore, rrethi i parë ku vepron EMU dhe ku ka vendndodhjen mbretëria e euros do të ishte njëmbëdhjetëshja tashmë e fiksuar e Gjermanisë, Francës, Italisë, Holandës, Austrisë Spanjës, Portugalisë dhe Luksenburgut. Rrethi i dytë periferik më i afërt i kontaktit do të mund të përbëhej nga vende të tilla si Anglia, Danimarka, Suedia dhe fqinja jonë e nderuar Greqia, që janë anëtare të Bashkimit Europian (BE). Rrethi i tretë, akoma më periferik, përfshin vendet e Europës Qendrore e Lindore e vende të tjera, të cilat nuk janë anëtare të BE, por kanë marrëveshje asociimi me të ose janë piketuar si kandidatë të para të mundshme për t’u pranuar. Dhe së fundi, rrethi i katërt dhe më i largët periferik nga Zona e Euros dhe EMU, përfaqëson vende, të cilat me gjithë përpjekjet dhe dëshirën e mirë për përfshirje, akoma nuk kanë marrëdhënie të institucionalizuara në marrëveshje asociimi me BE. Në këtë grup hyn edhe Shqipëria. Mbështetur në këtë përfytyrim, përgjigja e pyetjes është

e qartë për ne, e parë si në kuadrin e stabilitetit të treguesve makroekonomikë që duhet të plotësojë Shqipëria, ashtu dhe në cilësinë e sistemit financiar që ekziston e vepron aktualisht. Është akoma shpejt për ta imagjinuar përfshirjen. Por kjo nuk do të thotë aspak se kontakti me Zonën e Euros nuk do të ndihet në Shqipëri. Ne jemi të bindur se efektet e krijimit dhe funksionimit të një zone monetare të përbashkët të euros do të fillojnë të ndihen shumë shpejt. Banka e Shqipërisë (BSH) është e ndërgjegjshme se rruga për në euro do të jetë e gjatë. Kjo është dhe një nga arsyet që në projektstrategjinë e saj të zhvillimit banka e ka trajtuar këtë problem si një nga qëllimet strategjike afatgjata më të rëndësishmet.

Në të njëjtën kohë, ajo është e vetëdijshme se përpjekjet duhen filluar. Dhe tashmë ato kanë filluar, për të shtruar rrugën e antarësimit në euro. Për t'iu përgjigjur me cilësi këtij procesi, një sfidë më vete për Bankën e Shqipërisë përbën konsolidimi i një institucioni të pavarur e me autoritet. Mund të konstatojmë me kënaqësi se hapat ligjorë në këtë drejtim janë hedhur nëpërmjet Kushtetutës si dhe ligjit për Bankën e Shqipërisë, por duhet të punohet më shumë që shoqëria shqiptare të kuptojë rolin dhe vendin e Bankës së Shqipërisë. Në aspektin makroekonomik Banka e Shqipërisë së bashku me Ministrinë e Financave, po bashkëpunojnë me FMN-në, në kuadrin e programit ESAF, për të përmirësuar e më vonë stabilizuar treguesit makroekonomikë në kuota të kënaqshme.

Duke mbajtur parasysh kriteret e konvergjencës, të domosdoshme për anëtarësimin në EMU, ne na kërkohet të arrijmë inflacion të ulët (3 për qind) dhe të stabilizuar, normë interesi të ulët dhe të stabilizuar, kurs këmbimi të stabilizuar, deficit buxhetor të ulët (nën 3 për qind ndaj PBB si dhe borxh i përgjithshëm i ulët i qeverisë ndaj PBB (jo më shumë se 60 për qind). Gjithashtu, në kuadrin e programit ESAF, po punohet për ndryshimin dhe përmirësimin e sistemit financiar, duke synuar që viti 2000 të gjejë në Shqipëri një sistem bankar e financiar sa më të shëndetshëm dhe të ndërgjegjshëm për rolin e rëndësishëm të tyre në gjallërimin dhe rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë po punon me bankat tregtare që ato të bëjnë ndryshime, në mënyrë që futia në qarkullim e euros të bëhet sa më lehtësisht e prekshme dhe realitet në Shqipëri. Në këtë kuadër do të mbahen parasysh tre drejtime kryesore:

- a. Investimi në valutë dhe matja e riskut në kushtet e reja të krijuara
- b. Ndryshimi në kontabilitetin e bankave tregtare.
- c. Ndryshime në shërbimet e ofruara nga ana e bankave, qoftë në aspektin e investimeve ashtu dhe në atë të veprimeve valutore.

Një pyetje tjetër e natyrshme, që lind kur flitet për euron, është se cilat mund të jenë implikimet që do të ketë tregtimi i kësaj monedhe në ekonominë shqiptare? Përgjigja e kësaj nuk është e lehtë. Ajo përbën objekt të studimeve të mëtejshme, tashmë të filluara për Bankën e Shqipërisë. Sidoqoftë, ne mendojmë se efektet më të prekshme do të jenë pasqyra në pjesët përbërëse të bilancit të pagesave, të cilat si rrjedhojë do të sjellin dhe pasojat e tyre në zhvillimin e ekonomisë. Si pikë të parë mund të përmendim sjelljen e llogarisë korente. Kuptohet që, në kushtet e reja të krijuara, do të kemi një ulje të kostos si dhe do të kemi një transparencë më të prekshme për nivelin e çmimeve në vende të ndryshme për produkte të njëjta.

Por, duke marrë në konsideratë që volumi i eksport-importeve që kryhen me vendet e Europës (Itali, Gjermani) zë rreth 80 për qind të totalit të përgjithshëm të tregtisë së Shqipërisë, mund të pohohet se këtu do jenë dhe implikimet e mundshme për ekonominë shqiptare. Sigurisht, këtu do të ndikojë shkalla e fleksibilitetit të euros ndaj dollarit amerikan, kurset efektive reale të këmbimit si dhe fakti që vendet anëtare mund të paraqiten në nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik e të produktivitetit.

Konkretizimi i këtyre korelacioneve me shifra është në fazën fillestare për Bankën e Shqipërisë, por përbën një detyrë të saj prioritare të së ardhmes. Si pikë të dytë mund të përmendim sjelljen e llogarisë kapitale ku duhet marrë në konsideratë që Shqipëria e ka të lirë hyrjen e kapitalit nga jashtë, por ka kufizime për nxjerrjen e kapitalit, të cilat veprojnë më shumë mbi vendasit. Nga ana tjetër, duke nënkuptuar nivelin e rrezikut që mbart me vete investimi në asete të emetuara në lekë, si dhe duke njohur ndërlikimet e situatës në rajon, mund të themi se ndikimet në këtë pikë do të jenë, gjithashtu, të kufizuara.

Përsa i përket borxhit të jashtëm, ne presim që ai të influencohet disi nga politikat që do të ndiqen nga Banka Qendrore Europiane ndaj normave të interesit si dhe nga stabiliteti i vetë monedhës euro. Së fundi, si fushë tjetër me rëndësi të veçantë mund të përmendim ndryshimet që duhen bërë në formulimin e politikave ekonomike si dhe ato ligjore e institucionale për t'ju përshtatur më mirë kushteve të reja të krijuara. Adoptimi i të ashtuquajturës "për t'ju përshtatur" më mirë kushteve të reja të krijuara. Adaptimi i të ashtuquajturës "acquis communautaire" do të kërkojë domosdoshmërisht ndryshime në liberalizimin e qarkullimit të kapitaleve, në përgatitjen dhe firmosjen e dokumenteve të rëndësishme politike që do të adoptonin paktin e stabilitetit e të rritjes, tashmë të pranuar nga vendet anëtare të EMU, si

dhe të gjitha përgatitjet e domosdoshme ligjore dhe institucionale për ta bërë sistemin shqiptar të ekonomisë të funksionojë sipas rregullave normale komunitare. Banka e Shqipërisë edhe një herë shpreh bindjen e saj, se në bashkëpunim me partnerë që ndodhen më pranë me Zonën e Euros, mund të përfitojmë e të krijojmë atë eksperiencë të domosdoshme që i nevojitet një sistemi të ri finaciar e një banke të re qendrore, për të ecur në një ndërmarrje kaq të rëndësishme sa është ajo e përfshirjes në Zonën e Euros si dhe përshtatja me efektet e mundshme të saj.